



## **VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI**

**Data e miratimit: 17 tetor 2017**

**Numri i lëndës: 2016-27**

**Afrim Islami**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 17 tetor 2017, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar  
Znj. Elka ERMENKOVA, anëtare

Ndihmuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi me 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PRANË PANELIT**

1. Ankesa është regjistruar në Panel me datën 22 shtator 2016.

### **II. FAKTET**

2. Faktet e lëndës të paraqitura nga ankuesi mund të përmbliidhen si më poshtë:
3. Ankuesi ka parashtruar ankesën e tij në Panel me datën 22 shtator 2016 në lidhje me një çështje penale në pritje pranë Prokurorisë Themelore të Ferizajit.
4. Ankesa ka të bëjë me një mosmarrëveshjen pronësore midis parashtruesit të ankesës dhe Ndërmarrjes Publike Banesore (NPB). Kjo kishte rezultuar në paraburgimin e ankuesit dhe djalit të tij nga Policia e Kosovës në Stacionin e

Policisë Qendra në Prishtinë. Sipas ankesës, çështja po ashtu kishte rezultuar në dështimin e pretenduar nga ana e policisë për të mbrojtur ankuesin nga ngacmimet dhe për t'i paguar NPB-së 37,000 euro, shumë e cila ai pretendon se ligjërisht nuk nevojitej ta paguante.

5. Ankuesi ka parashtruar një ankesë më herët në Panel lidhur me të njëjtën çështje me datën 8 shkurt 2016 (Lënda nr. 2016-03, Afrim Islami kundër EULEX-it). Me 28 qershor 2016, Paneli ka gjetur këtë ankesë të papranueshme.
6. Lidhur me kërkesën e tij më të fundit të datës 29 gusht 2016, ankuesi ka kërkuar nga kryeprokurori i EULEX-it që të marrë përsipër këtë rast në "dyshimin e bazuar se ka përpjekje për të ushtruar ndikim në veprën penale". Kërkesa ishte bazuar në nenin 12 të Ligjit nr. 03/-53, Ligjin mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it të datës 13 mars 2008 ("Ligji mbi Kompetencat") (shih ligjin përkatës në fuqi).
7. Kryeprokurori i EULEX-it i ishte përgjigjur ankuesit me datën 7 shtator 2016 ku ka deklaruar se që nga data 30 maj 2014 mandati i EULEX-it kishte pësuar "ndryshime të mëdha" në atë që prokurorët e EULEX-it nuk mund të merrnin lëndë të reja, në përputhje me nenin 7(A) të Ligjit mbi Kompetencat, si dhe ligjin nr. 05/L-103, 2016 të datës 15 qershor 2016 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve në lidhje me Mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës (shih ligjin përkatës në fuqi).
8. Kryeprokurori i EULEX-it ka vazhduar t'i shpjegoj ankuesit se një lëndë mund t'i caktohej një prokurori të EULEX-it vetëm nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, që më pas duhej të bazohej në një kërkesë të arsyetuar nga kryeprokurori i Shtetit, dhe me marrjen e pëlqimit nga autoriteti kompetent i EULEX-it. Kjo mund të ndodhë vetëm kur plotësohen rrethanat e jashtëzakonshme të përcaktuara në nenin 7(A). Kryeprokurori i EULEX-it pastaj ka përshkruar rrethanat e jashtëzakonshme që ka thënë se do të duhej të ekzistojë para se të zbatohet neni 7(A): mosgatishmëria ose paaftësia nga ana e prokurorit të Kosovës për të vepruar në këtë lëndë; se ekspertiza dhe përvoja e prokurorit të EULEX-it ishte e nevojshme për të siguruar hetimin e duhur ose ndjekjen penale të çështjes dhe se ekzistonte një dyshim i bazuar në përpjekjet për të ndikuar në hetimin penal ose ndjekjen penale.
9. Kryeprokurori i EULEX-it më tej ka deklaruar se kërkesa e parashtruar nga ankuesi nuk ka arritur pragun që do të arsyetonte përfshirjen e prokurorëve të EULEX-it në këtë fazë të hetimeve penale.
10. Në lidhje me kryerjen e supozuar të sjelljes së keqe të prokurorëve të Kosovës, kryeprokurori i EULEX-it ka deklaruar se Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ishte organi përgjegjës për hetimin e akuzave për sjellje të këqija nga ana e prokurorëve të Kosovës. Kryeprokurori i EULEX-it ka këshilluar ankuesin se Zyra e Prokurorit Disiplinor ishte organ i pavarur që i shërbente KPK-së dhe se ishte përgjegjës për hetimin e sjelljeve të këqija nga ana e prokurorëve të Kosovës. Kryeprokurori i EULEX-it ka sugjeruar që ankuesi të paraqes ankesën e tij në KPK nëse kishte arsye për të besuar se kishte pasur sjellje të tilla nga ana e prokurorëve të Kosovës.
11. Kryeprokurori i EULEX-it më në fund e kishte njoftuar ankuesin se, ashtu siç ngjarjet për të cilat ai i referohej duhet të hetohen dhe ndiqen nga prokurorët e Kosovës, do ta përcjellte letrën e ankuesit tek Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit për shqyrtim.

12. Ankuesi ka paraqitur një letër tjetër tek kryeprokurori i EULEX-it me datën 4 prill 2017 me një kërkesë tjetër që EULEX-i ta merrte përsipër këtë çështje, përsëri në bazë të dispozitave të Ligjit mbi Kompetencat, duke deklaruar se: “janë paraqitur rrethana të reja dhe të jashtëzakonshme, siç është ndikimi politik, nga ana e zyrtarëve të lartë në rastin tim dhe një ndikim i tillë përfshin edhe prokurorët që kanë trajtuar rastin tim”.
13. Kryeprokurori i EULEX-it i ka dërguar ankuesit përgjigjen e tij me datën 12 prill 2017, në të cilën në thelb ai përsëriti atë që i ishte komunikuar ankuesit në letrën e datës 7 shtatorit 2016. Kryeprokurori i EULEX-it gjithashtu ka informuar ankuesin se zyra e tij nuk do të trajtonte ndonjë korrespondencë tjetër nga ankuesi lidhur me këtë çështje.

### **III. LIGJI PËRKATËS NË FUQI**

14. Dy dispozita të ligjit të Kosovës kanë të bëjnë me këtë çështje. Neni 12 i Ligjit mbi Kompetencat parasheh që prokurorët e EULEX-it mund të veprojnë në rast të mosgatishmërisë ose paaftësisë së prokurorëve publikë të Kosovës që të veprojnë në ndonjë çështje të veçantë ndryshe në kompetencë të Misionit.
15. Në nenin 7(A) të Ligjit mbi Kompetencat thuhet si vijon:

“Në rrethana të jashtëzakonshme me kërkesë të arsyetuar të kryeprokurorit të Shtetit, Këshilli Prokurorial mund të vendosë që çështja penale t’i caktohet një prokurori të EULEX-it, në pajtim me autoritetin kompetent të EULEX-it.”

### **IV. ANKESAT**

16. Duke mos u thirrur në ndonjë dispozitë të veçantë të instrumenteve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, mund të supozohet se ankuesi pohon shkelje të neneve si në vijim: se ishte paraburgosur padrejtësisht nga Policia e Kosovës (neni 5 i KEDNj-së); se i ishte mohuar e drejta e tij për një gjykim të drejtë (neni 6 i KEDNj-së); se i ishte mohuar e drejta e tij për një mjet efektiv juridik (neni 13 i KEDNj-së); dhe se kishte ndërhyrje në të drejtën e tij për gëzimin paqësor të pasurisë së tij (neni 1, Protokollin 1 i KEDNj-së).

### **V. LIGJI**

17. Si një çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar të zbatojë instrumentet e të drejtave të njeriut siç është reflektuar në Konceptin e Përgjegjshmërisë së EULEX-it të datës 29 tetor 2009 në OPLAN të EULEX-it në Kosovë për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.

18. Para shqyrtimit të ankesës në bazë të bazueshmërisë së saj, Paneli duhet të vendosë nëse do të vazhdojë me të, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullën 29, në lidhje me rregullën 25 të rregullores së punës.
19. Sipas rregullës 25, paragrafi 1, të rregullores së punës, Paneli mund të shqyrtojë vetëm ankesat në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv në sektorët e drejtësisë, policisë dhe doganave.
20. Në rastin në fjalë, Paneli thekson se nuk është argumentuar, e lëre më parë, se EULEX-i ishte në ndonjë mënyrë i përfshirë në shkeljet e pretenduara të të drejtave të ankuesit. As ankesa nuk tregon ndonjë dështim të fajshëm nga ana e EULEX-it për të vepruar në këtë çështje.
21. Për më tepër, rrethanat e paraqitura nga ankuesi në këtë rast nuk sugjerojnë që prokurorët e EULEX-it kanë vepruar në mënyrë të paarsyeshme ose arbitrare duke mos pranuar të ushtrojnë kompetencën e tyre "të jashtëzakonshme" në pajtim me nenin 7(A) të Ligjit mbi Kompetencat (në përgjithësi shih *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinovic, H.S. dhe I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 deri 2014-17, 19 tetor 2016, paragrafi 58 dhe referencat e tij në paragrafët 9, 10 dhe 49 në të njëjtin vendim *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinovic, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 deri në 2014-17, 30 shtator 2015, paragrafi 75, *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, 11 nëntor 2015, *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, 19 tetor 2016, paragrafi 32; *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinovic, H.S. dhe I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 deri 2014-17, 19 tetor 2016, par. 64, *Rejhane Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, 29 shtator 2015, paragrafi 62, *Mufail Halili kundër EULEX-it*, 2012-08, 15 janar 2013, paragrafi 28).
22. Prandaj këto çështje nuk hyjnë në kuadër të kompetencave të Panelit, siç është saktësuar në rregullën 25 të rregullores së punës (*Shaip Gashi kundër EULEX-it*, 2013-20, 26 nëntor 2013, paragrafi 9; *Jovanka, Dragan dhe Milan Vuković kundër EULEX-it*, nr. 2013-18, 7 prill 2014, par. 11-12).

## **PËR KËTO ARSYE,**

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, pasi ajo bie jashtë juridiksionit të tij brenda në bazë të nenit 29(d) të rregullores së vet të punës, dhe prandaj

## **SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.**

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese